

## Lidhja e Shkrimtarëve dhe Krijuesve Shqiptarë në Austri „Aleksandër Moisiu“, Vjenë

Gudrunstrasse 159/18  
1100 Vjenë  
ZVR.Zahl: 746750400



[www.moisiu.eu](http://www.moisiu.eu)  
[info@moisiu.eu](mailto:info@moisiu.eu)

## Protokoli nga Kuvendi i parë

**Data:** 30 nëntor 2014 (e diel)

**Vendi:** Keplerplatz 5, 1100 Vjenë

**Koha:** 16.30-19.45

### Rendi i ditës i kuvendit të parë të rregullt punues të LSHKSHA<sup>1</sup>

1. Fjalët përshëndetëse
2. Leximi, diskutimi, plotësimi dhe aprovimi i raportit të punës dhe atij financiar (2011-2014)
3. Pushim
4. Prezantimi i planit të veprimit të LSHKSHA “Aleksandër Moisiu” për vitin 2015
5. Të ndryshme

### Hapja e Kuvendit të parë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Krijuesve Shqiptarë në Austri

Hapjen e Kuvendit e bëri z. Anton Marku, sekretar dhe njëkohësisht arkëtar i Lidhjes me një urim mbi festën e Pavarësisë së Shqipërisë. Z. Marku propozoi dhe kryesinë e punës për drejtimin e kuvendit të parë të përbërë nga:

- Z. Hazir Mehmeti, kryetar i kryesisë së punës së kuvendit
- Z. Ajet Shira, anëtar i kryesisë së punës së kuvendit (mbajtës i protokollit) dhe
- Znj. Jehona Muja Sukaj, anëtare e kryesisë së punës së kuvendit

Kjo kryesi u aprovua unanimisht nga të pranishmit.

### 1. Fjalët përshëndetëse

Z. Hazir Mehmeti mori drejtimin e kuvendit duke ftuar z. Roland Bimo, ambasador i Republikës së Shqipërisë në Austri për të përshëndetur kuvendin. Ai falënderoi LSHKSHA “Aleksandër Moisiu” për ftesën, duke përshëndetur dhe përgëzuar për punën e bërë dhe me rastin e ditës së shpalljes së Pavarësisë përshëndeti dhe për këtë festë kombëtare. Nga ana politike shtroi rëndësinë për popullin shqiptar në politikën e sotme në rajon si dhe rëndësinë e funksionimit të LSHKSHA në jetën kulturore dhe artistike të shqiptarëve me banim në Austri.

---

<sup>1</sup> Lidhja e Shkrimtarëve dhe Krijuesve Shqiptarë në Austri

Në emër të KKSHTA<sup>2</sup> përshëndeti z. Abdulla Abdullahu.  
Në emër të LSHFA<sup>3</sup> foli z. Januz Saliuka

Atasheu ushtarak shqiptar në Austri z. Dedë Prenga përshëndeti në emër të tij duke falenderuar për ftesën dhe përgëzuar për rolin e LSHKSHA „Aleksandër Moisiu“ në jetën artistike të shqiptarëve në Austri, me besimin për një punë të mëtejshme të suksesshme si dhe në inspirimin e shqiptarëve të tjerë për t’iu bashkangjitur kësaj Lidhje. „Misioni dhe detyrimi që kjo Lidhje ka marrë përsipër edhe në të ardhmen të jetë një Lidhje pararojë në edukimin e brezave dhe përhapjes së gjuhës shqipe, besoj se do të vazhdojë dhe më tej veprimtarinë e saj“, tha ai.

Znj. Hana Klissura (Hana Këlcyra) përshëndeti gjithashtu kuvendin.

## **2. Leximi, diskutimi, plotësimi dhe aprovimi i raportit të punës dhe atij financiar (2011-2014)**

Z. Besim Xhelili përshëndeti në emër të LSHKSHA.

Më tej u vazhdua me raportin e punës së Lidhjes. Aktiviteti i Lidhjes ka tre vjet që vazhdon. Janë zhvilluar 25 orë letrare, ku 7 prej tyre në dy gjuhë. Bashkëpunimi me shoqata të tjera është zgjeruar më tej si me shoqata brenda ashtu dhe jashtë Austrisë. Ai falënderoi gjithashtu të dyja ambasadat shqiptare të Shqipërisë dhe Kosovës në Austri për përkrahjen e tyre në aktivitetet e zhvilluara. (një kopje e raportit të punës iu ofrua të pranishmeve në kuvend, faqe 11-15 nga Lista e Dokumenteve).

Z. Xhelili bëri një prezantim në formë kronologjike të aktiviteteve gjatë periudhës kohore prej tre vitesh. Besim Xhelili bëri gjithashtu dhe një historik të shkurtër të krijimit të Lidhjes nga bërthama e përbërë nga Besim Xhelili, Anton Marku, Amir Januzaj dhe Hazir Mehmeti dhe përzgjedhja e emrit të Lidhjes. Deri më sot ka patur 28 takime të kryesisë së Lidhjes, të protokolluara me procesverbal. Është bërë e mundur të botohen dy antologji. Është përpjekur që të ketë një kompensim për anëtarët që kanë marrë pjesë në aktivitete larg vendit ku jetojnë. Sfidë e Lidhjes ngelet botimi i një gazete dyjavore në gjuhën shqipe dhe gjermane, ashtu si e kanë bërë të mundur kombësitë e tjera në gjuhën e tyre. Do të bëhet hapja e një konkursi për krijuesit e rinj për të angazhuar dhe të rinjtë në fushën e krijimtarisë.

## **3. Pushim**

Pas një pauze të shkurtë vazhdoi punën kuvendi. Z. Anton Marku foli për vështirësitë e para të krijimit të Lidhjes, fazën e parë të punës, që ishte identifikimi i autorëve shqiptarë përtej Vjenës për të arritur në një numër prej 30 personash. Faza e dytë ka qenë fokusi tek institucionet austriake për të shprehur praninë e shqiptarëve në fushën e krijimtarisë. Faza e tretë ka patur për qëllim produktin (antologjia e krijuesve shqiptarë në Austri). „Illyricum“ është prezantimi më i denjë i Lidhjes së krijuesve shqiptarë në Austri. Synojmë që aktivitete të tilla të zhvillohen më tej.

---

<sup>2</sup> Këshilli Koordinues i Shoqatave Shqiptare në Austri

<sup>3</sup> Liga Shqiptare e Futbollit në Austri

Z. Marku bëri një prezantim të raportit financiar të Lidhjes në hapësirën kohore prej tre vjetësh.(Një kopje e librit të llogarisë u është dhënë të pranishmëve në kuvend, faqe 16-19). Një falenderim për ndihmën financiare u shpreh edhe për firmat apo individët që kanë kontribuar nga ana financiare në zhvillimin e aktiviteteve të Lidhjes.

Znj. Vlora Jonuzi i është bashkangjitur Lidhjes duke kontribuar me pagesën e anëtarësisë. Gjithashtu znj. Keti Berisha pagoi një donacion vullnetar prej 50 euro dhe e përshëndeti me disa fjalë kuvendin. Poashtu z. Mërgim Osmani tha disa fjalë përshëndetëse.

#### **4. Plani i veprimit për vitin 2015**

Z. Anton Marku bëri një prezantim të planit të veprimit për vitin 2015. (Shih faqe 20 nga Lista e dokumenteve).

#### **5. Të ndryshme**

Z. Zaim Toska përshëndeti gjithashtu kuvendin duke bërë dhe një propozim për rritjen e shumës së anëtarësisë në 100 euro në vit. Një propozim tjetër prej tij vjen dhe në fushën humanitare për krijimin e një shoqate humanitare për të ndihmuar njerëzit e varfër në trojet shqiptare.

Z. Ragip Dragusha shprehu keqardhjen e tij për largimin e z. Kurt Gostentschnigg nga Lidhja "Aleksandër Moisiu". Në të ardhmen duhet që t'i kushtojmë rëndësi kthimit të tij në Lidhjen tonë. Ai përgëzoi anëtarët e Lidhjes dhe miqtë tanë për kontributin e tyre.

Z. Dan Kosumi shprehu vlerësimin e tij për z. Gostentschnigg dhe punën e tij me një shpresë dhe lutje se ai do të kthehet përsëri.

Z. Driton Smakaj me banim në Hungari përshëndeti nga ana e përfaqësimit të shqiptarëve në Hungari. Me rastin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë është bërë një aktivitet në ambientet e Katedrës së Gjuhës Shqipe në Budapest dhe një aktivitet në ambientet e ambasadës së Shqipërisë në Hungari. Një propozim i tij ishte dhe një detajim i shpenzimeve nën emrin "Honorar".

Z. Marku shpjegoi përdorimin e honorareve, ku përfshihen kompensimet për personat që kanë marrë pjesë në aktivitete, në formën e pjesëve muzikore që aktiviteti të ketë disa momente shplohjeje apo ndryshimi në formën e aktivitetit.

Z. Hazir Mehmeti propozon nje rregullore mbi dhënien e honorareve. Ai vlerësoi punën e Lidhjes dhe në veçanti atë të Besimit, Antonit apo dhe Amirit në fillimet e idhjes. Fokusi ynë duhet të jetë edhe te poetët e tjerë, gjetja dhe identifikimi i krijuesve edhe nga fushat e tjera të artit (muzikë, pikturë etj.).

Znj. Dituri Neziraj shprehu mendimet e saj se Lidhja duhet të jetë e hapur edhe për aktivitete artistike për femijët dhe të rriturit në dramë, teatër, shfaqje me taban shqiptar. Kritikkat janë më të rëndësishme se lëvdatat, u shpreh ajo.

Z. Januz Saliuka përgëzoi për kontributin e dhënë nga Lidhja e krijuesve. Botimit të një gazete në gjuhën shqipe është e nevojshme që t'i jepet përparësi, por duhet gjetur hapësira e sponsorizimit, ku mundësite ekzistojnë, por kjo të jetë dygjuhëshe dhe të funksionojë rrjeti i shpërndarjes. Një rëndësi duhet t'i kushtohet dhe një kërkesë për krijimin e Katedrës së Gjuhës Shqipe në Vjenë, që të mundësohet dhe ndarja e gjuhës shqipe nga Katedra e Gjuhëve Sllave.

Kuvendi u dokumentua me foto dhe filmime me aprovimin e pjesëmarrësve.

Kryetari i kryesisë së punës së kuvendit z. Hazir Mehmeti pasi i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në kuvend dhe pasi askush nuk kishte më gjë për të thënë, e shpalli të mbyllur këtë kuvend, duke i ftuar të pranishmit në një koktej simbolik të rastit dhe duke u ofruar mundësinë të pranishmëve të shfletojnë dhe librat e sjellura nga autorët.

Kuvendi zgjedhor i LSHKSHA parashihet që të mbahet në nëntor të vitit 2015.

Bashkangjitur lista e pjesëmarrësve në kuvend.

1. Besim Xhelili
2. Anton Marku
3. Hazir Mehmeti
4. Dan Kosumi
5. Ragip Dragusha
6. Ajet Shira
7. Roland Bimo
8. Dedë Prenga
9. Dituri Neziraj
10. Driton Smakaj
11. Jehona Muja Sukaj
12. Hana Klissura (Hana Këlcyra)
13. Keti Berisha
14. Mërgim Osmani
15. Salih Gashi
16. Januz Saliuka
17. Abdullah Abdullahu
18. Vlorë Jonuzi
19. Zaim Toska
20. Dr. Sabri Osmani
21. Flamur Xhelili

Protokollin e përpiloi: Ajet Shira

Verifikuan dhe aprovuan: Besim Xhelili dhe Anton Marku

Vjenë, 6 dhjetor 2014